



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 qershor 2021
Nr. ref.:RK1812/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI51/21

Parashtrues

Skender Hyseni

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 229/2020, të 14 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Skender Hyseni, nga fshati Batllavë, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 229/2020], të 14 janarit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), lidhur me Aktvendimin [Ac. nr.859/16] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 11 dhjetorit 2019 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit.
6. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu, (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 24 mars 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
9. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH51/21 emëroi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu. Gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi u caktua kryesuese e Kolegjit shqyrtues.
10. Më 2 qershor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune në Ndërmarrjen Publike "Termokos" në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).
12. Më 14 dhjetor 2007, parashtruesi i kërkesës, konform Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja nr. 2001/27) kishte nënshkruar me punëdhënësin kontratën e punës [nr. 828/25] në kohë të caktuar, me kohëzgjatje deri më 30 shtator 2008.
13. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar pushim pa pagesë nga punëdhënësi në afat prej 12 (dymbëdhjetë) muajve me arsyetimin se bashkëshortja e tij ishte e sëmurë dhe kishte nevojë për shërim jashtë vendit.
14. Më 8 maj 2008, përmes Vendimit [nr. 409] punëdhënësi kishte lejuar pushimin pa pagesë për parashtruesin e kërkesës në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe atë nga 12 qershori 2008 deri më 12 shtator 2008, me mundësi vazhdimi edhe për 3 (tre) muaj.
15. Më 23 janar 2009, parashtruesi i kërkesës ishte paraqitur në punë tek punëdhënësi, me ç'rast ishte njoftuar se atij i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të mosrespektimit të afatit për kthim në punë pas pushimit pa pagesë, përkatësisht më 12 shtator 2008.
16. Më 24 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës përmes shkresës [nr. 368] kishte kërkuar kthimin në vendin e punës, por për këtë nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje në formë të shkruar nga punëdhënësi.
17. Më 18 mars 2009, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), duke kërkuar që punëdhënësi të detyrohet të kthej parashtruesin e kërkesës në vendin e punës dhe atij ti kompensojë pagat e papaguara.
18. Më 1 mars 2011, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C. nr. 555/09]: i) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për kthim në vendin e punës si të pabazuar; ndërsa ii) detyroi punëdhënësin që t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës pagat mujore nga 13 dhjetori 2008, deri në përmbarimin e Aktgjykimit të saj.
19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit [C. nr. 555/09] të Gjykatës Komunale për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankesë kishte paraqitur edhe punëdhënësi, mes tjerash, për shkak se diapozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte i paqartë.
20. Më 9 tetor 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC. nr. 5189/2012] pranoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ankesën e punëdhënësit dhe prishi Aktgjykimin [C. nr. 555/09] të Gjykatës Komunale dhe çështjen e ktheu për rivendosje në Gjykatën Komunale, pasi konstatoi se kjo e fundit kishte

shkelur dispozitat e procedurës kontestimore dhe nuk kishte vlerësuar drejtë gjendjen faktike.

21. Më 7 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C. nr. 2907/13] e aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës duke detyruar punëdhënësin që ta kthej parashtruesin e kërkesës në vendin e punës, Furnizues në Shërbimin Ekonomik dhe Financiar në Prishtinë, si dhe t’ia kompensojë pagat dhe kontributet pensionale për periudhën nga 13 dhjetori 2008 deri më 30 qershor 2015.
22. Në një datë të pasaktësuar, punëdhënësi në Gjykatën e Apelit paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit [C. nr. 2907/13] të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 11 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC. nr. 859/16] pranoi ankesën e punëdhënësit dhe prishi Aktgjykimin [C. nr. 2907/13] të Gjykatës Themelore dhe hudhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës duke konstatuar se padia e parashtruesit të kërkesës ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi sipas nenit 83, paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së (në tekstin e mëtejshëm: LDTHMP), përcaktohet që nëse punëmarrësi nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent ose nëse ky organ nuk merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje të të drejtave të tij në gjykatën kompetente brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Në këtë rast, Gjykata e Apelit konstatoi se marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës tek punëdhënësi kishte pushuar më 1 tetor 2008 (kur kishte skaduar kontrata e tij e punës me afat të caktuar), ndërkohë që ai nuk ishte paraqitur në punë nga 13 shtatori 2008, dhe cili ishte lajmëruar në vendin e punës më 23 janar 2009, ndërsa padinë e kishte paraqitur më 18 mars 2009.
24. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme ndaj Aktvendimit [AC. nr. 859/16] të Gjykatës së Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pretenduar, mes tjerash se, LDTHMP nuk ishte i aplikueshëm në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 për Ligjet në Fuqi në Kosovë e ndryshuar përmes Rregullores nr. 2000/59 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja nr. 1999/24), pasi sipas kësaj të fundit, ligje të aplikueshme në Kosovë janë rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet në fuqi deri më 22 mars 1989, ndërsa LDTHMP ishte shpallur në Gazetën Zyrtare më 28 shtator 1989, pra pas 22 marsit 1989.
25. Më 14 janar 2021, Gjykata Supreme refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Supreme gjeti se Gjykata e Apelit me të drejtë ka aplikuar dispozitat e nenit 83, paragrafi 1 të LPDTHMP-së pasi i njëjti ishte i aplikueshëm në Kosovë konform nenit 1.2 të Rregullores nr. 24/1999, ku ishte përcaktuar se nëse *“një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 [të Rregullores 1999/24] por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose*

personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj". Sipas Gjykatës Supreme, në rastin konkret, pasi Rregullorja nr. 2001/27, me të cilën ishte shpallur Ligji Themelor i Punës në Kosovë, nuk ka dispozita sa i përket afateve për ushtrimin e padisë, me nenin 11.1 pika d) të Rregullores nr. 2001/27, është paraparë që shkëputja e kontratës së punës bëhet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe në këtë rast paditësit kontrata e punës i ka skaduar më 1 tetor 2008, dhe padia është ushtruar më 18 mars 2009, pra jashtë afatit të përcaktuar ligjor, andaj pretendimi në revizion sa i përket llogaritjes së afatit është tërësisht i pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendimet për shkelje kushtetuese i ndërton duke u bazuar në dy argumente kryesore, duke theksuar fillimisht se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë qenë të detyruara që të bazohen në dispozitat e Rregullores nr. 2001/27 pasi që kjo Rregullore kishte përcaktuar të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës. Fakti që Rregullorja nr. 2001/27 nuk ka paraparë afate për mbrojtjen gjyqësore e të drejtës nga marrëdhënia e punës, nuk e autorizon gjykatën që për çështjen e afatshmërisë të aplikojë dispozita të ligjit i cili ka qenë në fuqi para aprovimit të Rregullores nr. 2001/27.
28. Për më tepër, ai thekson se vet aplikimi i nenit 83 të LDTHMP-së përbën diskriminim ngase neni 27 i Rregullores nr. 2001/27, kishte shfuqizuar të gjitha dispozitat në fuqi e që ishin në kundërshtim me këtë të fundit.
29. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se, ai *"me kërkesën nr. 368 të datës 24.02.2009 i ishte drejtuar punëdhënësit për kthim në punë, por nuk kishte marrë përgjigje. Padia është parashtruar me datën 18.03.2009, që nënkupton se nga parashtrimi i kërkesës për kthim në punë nuk kishte kaluar 30 ditë. Edhe nën kushtin e mundësisë së aplikimit të një ligji tjetër për një çështje nga marrëdhënia e punës siç është afati i mbrojtjes gjyqësore nga marrëdhënia e punës, ky afat do duhej të vlerësohej duke iu referuar datës kur parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar me shkrim kthimin në punë (24.02.2009)".* Ai shton se në rastin e parashtruesit të kërkesës vlerësohet afatshmëria e padisë, derisa nuk kishte vendim përfundimtar të punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Kësisoj, Gjykata me interpretim diskriminues edhe të nenit 83 pa bazë e cilëson padinë si të paafatshme. Lidhur më këtë, ai thekson se e veçantë e rregullimit të mbrojtjes gjyqësore për përfundimin e marrëdhënies së punës se nevojitet vendim përfundimtar i punëdhënësit në shkallën e dytë.
30. Parashtruesi gjithashtu pretendon se *"aplikimi diskriminues përbën edhe qëndrimi kontradiktor i gjykatës [Supreme] ngase gjykata [Supreme] e vlerëson si të drejtë qëndrimin për afatshmërinë e padisë ndërsa e konfirmon se Rregullorja nr. 2001/27 nuk parasheh afate për ushtrimin e padisë por se gjoja me nenin 11, paragrafi 11. 1 pika (d) është paraparë në citat. " ... që shkëputja e kontratës së punës bëhet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe në këtë rast paditësit kontrata i ka skaduar me datën 01.10.2008 ...".*

31. Andaj, parashtruesi i kërkesë mbi bazën e argumenteve të lartcekura, pretendon shkelje të neneve 31 dhe 49 të Kushtetutës.
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 229/2020; dhe (iii) të kthej rastin në rishqyrtim.

Dispozitat Relevante Ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 për Ligjet në Fuqi në Kosovë, e ndryshuar përmes Rregullores 2000/59

“Neni 1 Ligji në Fuqi

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Ligjin në fuqi në Kosovë, më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut [...].”

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës

“Neni 10 Kontrata e punës

10.1 Kontrata e punës mund të lidhet:

(a) për një kohë të pacaktuar ose

(b) për një kohë të caktuar.

[...]

Neni 11 Shkëputja e kontratës së punës

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

[...]

(d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe
(dh) sipas fuqisë ligjore.

[...]"

**Neni 27
Ligji në fuqi**

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

[...]"

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

**Neni 47
(Kërkesa individuale)**

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

**Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)**

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 229/2020] të 14 janarit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
37. Më tutje, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu rastin K1175/21, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të

pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, gjithashtu shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).

40. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).

Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës

41. Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se gjykatat e rregullta kanë aplikuar ligjin e gabuar, respektivisht gabimisht kanë aplikuar ligjin e aplikueshëm konkretisht se: (i) Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit në mënyrë diskriminuese kanë aplikuar LDTHMP-së pasi ky i fundit nuk ka qenë i aplikueshëm në rastin konkret, dhe (ii) Gjykatat e rregullta kanë bërë interpretim diskriminues të LDTHMP-së pasi edhe sikur të aplikohesh LDTHMP, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padinë brenda afatit ligjor pasi ai nuk kishte pranuar asnjëherë vendim për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës pretendimin se ai është diskriminuar e ndërlidh me aplikimin e gabuar të legjislacionit në fuqi.
42. Gjykata, fillimisht, vë në dukje se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastin e Gjykatës KI185/19, parashtrues: *Abdylhadi Petlla*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2020, paragrafi 40). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih rastet e Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 40; KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
43. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil (shih rastin e Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 46).
44. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë

ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli parësor i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin e Gjykatës KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

45. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjoen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (shih, rastin e Gjykatës KI42/16, parashtues *Valdet Suta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
46. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtuesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar (shih, rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 53).
47. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e cila pranoi ankesën e punëdhënësit dhe prishi Aktgjykimin [C. nr. 2907/13] të Gjykatës Themelore dhe hudhi poshtë padinë e parashtuesit të kërkesës kishte arsyetuar vendimin e saj duke theksuar se padia e parashtuesit të kërkesës ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi sipas nenit 83, paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së (në tekstin e mëtejme: LDTHMP), përcaktohet që nëse punëmarrësi nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent ose nëse ky organ nuk merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje të të drejtave të tij në gjykatën kompetente brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Në këtë rast, Gjykata e Apelit konstatoi se marrëdhënia e punës së parashtuesit të kërkesës tek punëdhënësi kishte pushuar më 1 tetor 2008 (kur kishte skaduar kontrata e tij e punës me afat të caktuar), ndërkohë që ai nuk ishte paraqitur në punë nga 13 shtatori 2008, dhe cili ishte lajmëruar në vendin e punës më 23 janar 2009, ndërsa padinë e kishte paraqitur më 18 mars 2009.
48. Ndërsa, Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e parashtuesit të kërkesës që ndërlidhen me aplikueshmërinë e LDTHMP-së në rastin e tij, dhe afatin për paraqitjen e padisë që ndërlidhet me ditët e shkëputjes së kontratës së punës, theksoi se këto pretendime janë të pabazuara pasi konstatoi se Gjykata e Apelit me të drejtë ka aplikuar dispozitat e nenit 83, paragrafi 1 të LDTHMP-së pasi i njëjti ishte i aplikueshëm në Kosovë “konform nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 24/1999, ku ishte përcaktuar se “Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj”. Në rastin

konkret, pasi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 me të cilin ishte shpallur Ligji Themelor i Punës në Kosovë, nuk ka dispozita sa i përket afateve për ushtrimin e padisë. Me nenin 11.1 pika d) të kësaj rregulloreje [nr. 2001/27], është paraparë që shkëputja e kontratës së punës bëhet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe në këtë rast paditësit kontrata e punës i ka skaduar me datë 01.10.2008, dhe padia është ushtruar me datë 18.03.2009, pra jashtë afatit të përcaktuar ligjor, andaj pretendimi në revizion sa i përket llogaritjes së afatit është tërësisht i pa bazuar”.

49. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës se: (i) Gjykata e Apelit gabimisht ka aplikuar LDTHMP-së i cili nuk ka qenë i aplikueshëm në rastin konkret, dhe pretendimin se (ii) edhe sikur të aplikohet LDTHMP, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padinë brenda afatit ligjor pasi ai nuk kishte pranuar asnjëherë vendim për shkëputjen e marrëdhënies së punës.
50. Kjo pasi sa i përket pretendimit (i), Gjykata Supreme kishte theksuar se LDTHMP-së i 28 shtatorit 1989 ishte i aplikueshëm në rastin konkret konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 24/1999, konkretisht paragrafit 1.2 të nenit 1 të saj dhe konform Rregullores nr. 2001/27 që përcakton se nëse një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet në fuqi më 22 mars 1989, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj. Në rastin konkret Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 me të cilin ishte shpallur Ligji Themelor i Punës në Kosovë, nuk kishte dispozita sa i përket afateve për ushtrimin e padisë, andaj ishte aplikuar LDTHMP; dhe sa i përket pretendimit (ii), Gjykata Supreme kishte theksuar se kontrata e punës së parashtruesit të kërkesës kishte përfunduar më 1 tetor 2008, kur edhe kishte kaluar afati i paraparë me kontratën e punës, konform nenit 11.1, pika (d) të Rregullores nr. 2001/27, andaj afati për paraqitjen e padisë ka filluar më 1 tetor 2008, dhe rrjedhimisht, padia ishte paraqitur më 18 mars 2009, pra jashtë afatit të paraparë me LDTHMP, .
51. Gjykata rrjedhimisht konstaton se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues: *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
52. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit

të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngre pretendim të argumentueshëm kushtetues për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, rastet Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 49; dhe KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

53. Andaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për shkak interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së Punës.

Lidhur me të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës

54. Sa i përket shkeljeve të së drejtës për punë dhe ushtrim të profesionit të me nenin 49 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtuesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (Shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtuesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera zë brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42)
55. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, por përtej argumenteve të cilat janë trajtuar më lart lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e nenit 49 të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të

argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21 cituar më lart, paragrafi 38- 39).

56. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje nenit 49 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse këtë pretendim e cilësohen si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

57. Si përfundim, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuar me nenet 31 dhe 49 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë e (i) pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 qershor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi